



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. lfaq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-3736/14
Data Datum Date	24.10.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.10.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3480-14 për znj. *Besa Curri-Limani* – *Udhëheqëse e Divizionit për buxhet e financa në Ministrinë e Integriteteve Evropiane (MIE)*, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3480-14, për Zyrtaren e lartë, znj. Besa Curri-Limani-Udhëheqëse e Divizionit për buxhet e financa në Ministrinë e Integriteteve Evropiane (MIE) dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Besa Curri-Limani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ajo është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Curri-Limani është deklaruar do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Curri-Limani, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-3671/14) bashkë me "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te biznesi privat, D.P.T. "Select" znj. Curri-Limani, për të parandaluar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik, ashtu siç e kërkon ligji, ka heq dorë nga te qenurit personi i autorizuar i biznesit privat. Tani, znj.

Curri-Limani, ushtron vetëm funksionin e saj publik Udhëheqëse e Divizionit për buxhet e financa në kuadër të MIE.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

